



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.80

Prishtinë, më 23.5.2024, në orën 9:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204.

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ardian Gola, kryetar, Albena Reshitaj, Enis Kervan, Eliza Hoxha, Arijeta Rexhepi, Jahja Kokaj, Arjeta Fejza. Adriana Matoshi dhe Vlora Dumoshi.

Mungoi: Ardian Kastrati.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi: Ardian Gola, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 21.05.2024;
3. Shqyrtimi i raporteve të Komisioneve të përhershme për Projektligjin nr.08/L-264 për Rininë;
4. Shqyrtimi i raporteve të Komisioneve të përhershme për Projektligjin nr.08/L-277 për Sport;
5. Të ndryshme.

Kryetari, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21.5.2024

Procesverbali i mbledhjes së mbajtura më 21.5.2024, miratua pa vërejtje.

3.Shqyrtimi i raporteve të Komisioneve të përhershme për Projektligjin nr.08/L-264 për Rininë

Ardian Gola, tha se Komisionet e Përhershme të Kuvendit Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, Komisioni për Legjislacion, Mandate Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, Komisioni për Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim dhe Komisioni për Integritime Evropiane, kanë bërë shqyrtimin e amendamenteve në Projektligjin për Rininë, në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe në raportet e tyre kanë konstatuar se amendamentet e Komisionit janë në pajtim me Kushtetutën, nuk përmbajnë kosto shtesë buxhetore, nuk prekin të drejtat e komuniteteve dhe amendamentet e propozuara nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Albena Reshitaj tha se përkrahë të dy Projektligjet, përkundër ngutisë për shqyrtimin e tyre, fuqizimi i rinisë dhe sporti janë dy fusha me rëndësi të veçantë në Republikën e Kosovës.

Anëtarët e Komisionit me shtatë (7) vota për, asnjë kundër, e ansnjë abstenim miratuan raportin me rekomandime për Projektligjin nr.08/L-264 për Rininë dhe e procedojnë në Seancë Plenare për shqyrtim të dytë.

4.Shqyrtimi i raporteve të Komisioneve të përhershme për Projektligjin nr.08/L-277 për Sport

Ardian Gola, tha se Komisionet e Përhershme të Kuvendit kanë bërë shqyrtimin e amendamenteve në Projektligjin për Sport, në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe në raportet e tyre kanë konstatuar se amendamentet e Komisionit janë në pajtim me Kushtetutën, nuk përmbajnë kosto shtesë buxhetore, nuk prekin të drejtat e komuniteteve dhe amendamentet e propozuara nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Anëtarët e Komisionit me shtatë (7) vota për asnjë kundër, e ansnjë abstenim miratuan raportin me rekomandime për Projektligjin nr.08/L-277 për Sport dhe e procedojnë në Seancë Plenare për shqyrtim të dytë.

5.Të ndryshme

Eliza Hoxha, theksoi nevojën e shqyrtimit të raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.05/L-90 për Sponzorizime në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-116. Raporti është përfundu ka mbetur rekomandimet të shqyrtohen dhe të procedohet për miratim në seancë plenare.

Anëtarët e Komisionit vendosën që në mbledhjen e radhës të shqyrtohen rekomandimet nga ky raport.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30

E përgatiti

Stafi mbështetës i Komisionit.

Ardian Gola,

Kryetar i Komisionit